



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE

PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMET PËRFUNDIMTARE
NË KUALIFIKIMIN PROFESIONAL “MOBILERI DHE TAPICERI”

(Niveli III në KSHK¹, referuar Niveli III në KEK²)

Kodi: C1-III-23

TIRANË, 2024

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Programi orientues për provimet përfundimtare të kualifikimin profesional “**Mobileri dhe tapiceri**”, **Niveli III në KSHK, referuar Niveli III në KEK**, përmban temat dhe kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë kualifikim, të trajtuara në lëndët profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale në klasën e këtij niveli, të cilat do të shërbejnë si bazë për të konceptuar provimet teorike dhe praktike përkatëse.

Ky program i ndihmon individët të përqendrohen në ato njohuri (koncepte, parime, ligjësi, procedura etj.) dhe kompetenca profesionale, që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu, edhe mësimdhënësit për organizimin e punës në përgatitjen për kontrollin përfundimtar të arritjeve të nxënësve.

Për drejtuesit e shkollave profesionale, këto programe krijojnë mundësinë për planifikimin dhe realizimin e Provimeve Përfundimtare në nivel shkolle.

Gjatë punës me këto programe kujdes duhet t’i kushtohet përvetësimit të njohurive dhe kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e individëve në botën e punës, por edhe që krijojnë vazhdimësinë e shkollimit të tij/saj në nivelin tjetër.

Gjatë përgatitjes së nxënësve për provimet përfundimtare të niveleve, është e rëndësishme që paraprakisht mësimdhënësit të zhvillojnë teste të individëve, me teste teorike apo praktike, të cilat mund t’i hartojnë vetë, duke përdorur instrumente vlerësimi në përputhje me kërkesat e këtij dokumenti. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh njohuritë dhe kompetencat e përfshira në këtë program, kriteret e vlerësimit të përcaktuara në modulet përkatëse si edhe udhëzimet për vlerësimin e individëve.

Programi orientues përbëhet nga dy pjesë:

- Programi orientues për provimin e teorisë profesionale të integruar;
- Programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar.

A) Programi orientues për Provimin e Teorisë Profesionale të integruar

Programi orientues për provimin e teorisë profesionale të integruar, në kualifikimin profesional “**Mobileri dhe tapiceri**”, **Niveli III në KSHK, referuar Niveli III në KEK**, është hartuar duke u mbështetur në temat më të rëndësishme të programeve të lëndëve profesionale më përfaqësuese dhe më thelbësore, të cilat përbëjnë 35% të vëllimit të përgjithshëm të lëndëve profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

Lëndët profesionale të përzgjedhura për t’u përfshirë në provimin e teorisë profesionale dhe temat e përzgjedhura, janë si më poshtë.

Lëndët dhe peshat përkatëse në programin orientues:

Nr.	Lënda	Vëllimi i orëve për lëndën	Peshat në %
1	Veglat dhe makineritë e përpunimit të drurit	31	38
2	Ndërtimi i objekteve prej druri	33	40
3	Ndërtimi i objekteve të tapicuara	18	22
	TOTALI	82	100%

Temat sipas lëndëve janë:

Temat nga lënda “**Veglat dhe makineritë e përpunimit të drurit**”, kl.12: **(31 orë)**

Tema 2	Makinat e frezimit	9 orë
Tema 4	Makinat e thithëzimit	8 orë
Tema 5	Makinat e tornimit	6 orë
Tema 9	Makinat e kalibrimit dhe formatizimit	8 orë

Temat nga lënda “**Ndërtimi i objekteve prej druri**”, kl. 12: **(33 orë)**

Tema 2	Pajisjet dhe makineritë për ndërtimin e mobilieve	7 orë
Tema 4	Montimi artizanal i mobilieve	5 orë
Tema 8	Patinimi i drurit	5 orë
Tema 10	Lustrimi i drurit	8 orë
Tema 12	Ndërtimi i objekteve të tjera prej druri	8 orë

Temat nga lënda “**Ndërtimi i objekteve të tapicuara**”, kl. 12: **(18 orë)**

Tema 2	Veglat, pajisjet dhe makinat për tapiceri	5 orë
Tema 3	Përgatitja e skeleteve të objekteve të tapicuara	6 orë
Tema 5	Tapiceria e mobilieve me bazë suste dhe sfungjeri	7 orë

Udhëzime për përgatitjen e testit të provimit të teorisë profesionale:

Provimi i teorisë profesionale të integruar do të jetë me test me shkrim, i cili zgjat 1.5 orë dhe përgatitet nga Komisioni i Provimit Përfundimtar i kualifikimit përkatës. Për hartimin e testit komisioni mund të mbështetet edhe tek banka e testeve e përgatitur nga AKAFPK-ja. Në hartimin e testit komisioni duhet të mbajë parasysh rregullat, parimet dhe formatet për ndërtimin e testit.

Testi duhet të përmbajë 30 njësi testi me një total prej 60 pikë. Nga këto, 20 njësi testi të jenë me zgjedhje të shumëfishtë (4 alternativa) dhe 10 të tjerat të jenë njësi testi me përgjigje të kufizuara/të mbyllura (me PO/JO; me e Vërtete e Gabuar; me plotësim të fjalës që mungon; etj.) Testi duhet të shmang pyetjet e hapura.

Njësitë e testit duhet të jenë të niveleve të ndryshme të vështirësisë, duke ndjekur skemën me tri nivele, si më poshtë:

Model i shpërndarjes së pikëve për pyetje të niveleve të ndryshme në test

Niveli I (i ulët)	Niveli II (mesatar)	Niveli III (i lartë)
Aftësia për të rikujtuar/kuptuar/identifikuar dhe për të përshkruar...	Aftësia për të zbatuar/argumentuar/shpjeguar/krahasuar dhe për të analizuar...	Aftësia për të vlerësuar dhe për të nxjerrë përfundime...

Ndarja e pikëve sipas peshës së çdo lënde dhe niveleve:

Nr.	Lënda	Peshat e lëndëve në %	Pikët për çdo lëndë	Ndarja e pikëve sipas niveleve të vështirësisë		
				Niveli I 40% e pikëve	Niveli II 40% e pikëve	Niveli III 20% e pikëve
1	Veglat dhe makineritë e përpunimit të drurit	38	23	9	9	5
2	Ndërtimi i objekteve prej druri	40	24	10	10	4
3	Ndërtimi i objekteve të tapicuara	22	13	5	5	3
TOTALI		100%	60 pikë	24 pikë	24 pikë	12 pikë

Përcaktimi i pikëve për çdo njësi testi bëhet duke pasur parasysh tipin e njësisë së testit. Për shembull: njësitë e testit me zgjedhje të shumëfishtë marrin gjithmonë 1 (një) pikë përkundërt përgjigjes së paracaktuar të saktë; njësitë me përgjigje të hapur marrin aq pikë sa kërkesa kanë brenda tyre (duke mbajtur parasysh edhe argumentimin nga nxënësi); njësitë me përgjigje të kufizuara marrin aq pikë sa gjykohet nga grupi hartues dhe kjo lidhet me kërkesat që parashtrihen në pyetje dhe niveli i vështirësisë.

Së fundi, skema e vendosjes së notës kundrejt pikëve të fituara përcaktohet nga grupi hartues i testit. Në vijim, jepet një model i skemës së vlerësimit pikë-notë:

Pikët e fituara	Notat
0 - 10	4
11 - 15	5

16 - 20	6
21 - 30	7
31 - 40	8
41 - 50	9
51 - 60	10

B) Programi orientues për Provimin e Praktikës Profesionale të integruar

Programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar, në profilin mësimor “**Mobileri dhe tapiceri**” është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

Lista e kompetencave profesionale për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, **detyrat e punës** dhe **pikët** për secilën kompetencë:

Nr	Kompetencat profesionale	Detyrat e punës	Pikët
1.	Të kryejë punime druri me mjete të dorës dhe me makina	Detyra 1: Punime druri me mjete të dorës dhe me makina Vlerësimi i një ose më shumë punimeve me mjete të dorës dhe me makina: 1. Kryerja e punimeve me mjete të mekanizuara të dorës, si: sharra, zdrukthe, trapano, frezë dhe zumparuese. 2. Kryerja e punimeve me makinat bazë të përpunimit të drurit si sharrë shirit, disk, plan, grosetë. 3. Kryerja e punime me makinat e shpimit, frezimit dhe thithëzimit.	20
2	Të kryejë punime në dritaren dhe derën prej druri	Detyra 2: Punimi i dritares dhe derës prej druri Vlerësimi i një ose më shumë proceseve të punës për punimin e dritares dhe derës prej druri 1. Punimi i elementeve për dritare dhe derë druri në makina. 2. Montimi i dritares dhe derës prej druri. 3. Kryerja llogaritje të thjeshta ekonomike për prodhimin e dritares dhe derës prej druri.	20
3	Të kryejë punime veshje me tapiceri	Detyra 3: Punime veshje me tapiceri të sipërfaqeve të ndryshme Vlerësimi i një ose më shumë punimeve të	15

		<p>veshjes me tapiceri të sipërfaqeve të ndryshme:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përgatitja e sipërfaqes prej pllake ose telajo. 2. Kryeja e punimeve për veshjen me tapiceri të sipërfaqes. 3. Kryeja e llogaritje të thjeshta ekonomike për veshjen me tapiceri të sipërfaqes. 	
4	Të kryejë punime montimi të objekteve prej druri	<p>Detyra 4: Montimi i objekteve prej druri. Vlerësimi i njërit ose më shumë punimeve të montimit të objekteve prej druri:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Montimi i objekte të thjeshta në mënyrë artizanale. 2. Montimi i kuzhinës të thjeshtë (bufe) në objekt. 	15
5	Të kryejë punime të patinimi, lustrimi, riparimi dhe restaurimi të mobilieve	<p>Detyra 5: Patinimi, lustrimi, riparimi dhe restaurimi të mobilieve. Vlerësimi i njërit ose më shumë proceseve të patinimi, lustrimit, riparimit dhe restaurimit të mobilieve.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kryerja e punimeve për riparimin gjatë ndërtimit të mobilieve dhe tapicerisë. 2. Kryerja e proceseve të imitimit, patinimit dhe lustrimit me pllaka dhe detale prej druri 3. Kryerja e punime për restaurimin e mobilieve të vjetra. 4. Kryerja llogaritjeve të thjeshta ekonomike në punime patinimi, lustrimi, riparimi apo restaurimi të mobilies. 	20
6	Të kryejë punime të mobilies së tapicuar në skelete të ndryshme	<p>Detyra 6: Punimi i mobilies së tapicuar në skelete të ndryshme Vlerësimi i njërit ose më shumë proceseve të punimeve të mobilies së tapicuar në skelete të ndryshme.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kryerja e punimeve të skeletit prej druri, fibre, kompensate. 2. Kryerja e veshjeve me tapiceri të skeletit. 3. Kryerja e llogaritjeve të thjeshta ekonomike për prodhimin e mobilies të tapicuar. 	10
Shuma			100

Shënime:

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve në “detyra pune”, grupe pune ose në mënyrë individuale, në bazën prodhuese të shkollës.
- Nxënësit do të vlerësohen për të paktën një ose dy prej detyrave të mësipërme, për shkak të kohës të përcaktuar të provimit.
- Koha për realizimin e të gjitha detyrave duhet të jetë jo më shumë se 3 (tri) orë, në përputhje kjo me Udhëzimin “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në arsimin dhe formimin profesional”, në fuqi.
- Në vlerësimin e kompetencave profesionale, rekomandohet t’i lihet hapësirë për vlerësime edhe bashkëbisedimit profesional ndërmjet komisionit dhe nxënësit, pasi ai është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara.
- Në çdo detyrë respektimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit duhet të jenë domosdoshmërisht të përfshira në vlerësim.
- Për çdo detyrë, komisioni i vlerësimit duhet të përgatisë instrumentet përkatëse të vlerësimit sipas kompetencave profesionale. Instrumenti i vlerësimit për secilën detyrë duhet të përfshijë të gjitha hapat e realizimit të saj, duke filluar nga përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës, higjienizimin e tyre, zgjedhja e materialeve kryesore dhe ndihmëse deri te punimet e ndryshme mbi materialin drunor për përfundimin e saj.
- Për realizimin e detyrave, nxënësve duhet t’u sigurohen mjete, pajisjet si dhe materialet për realizimin e tyre.
- Nxënësit duhet të realizojnë të gjitha etapat për realizimin e detyrave.
- Instrumenti i vlerësimit duhet të përfshijë në përmbajtjen e tij edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale si vetëkontrolli, përgjegjshmëria, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme si dhe komunikimi, bashkëpunimi në grup, bashkëveprimi ndërmjet njëri tjetrit etj.
- Gjithashtu, komisioni duhet të hartojë dhe një listë kriteresh vlerësimi për çdo detyrë në bazë të instrumenteve përkatëse të vlerësimit.
- Komisioni i provimit për çdo detyrë parapërgatit tezat e provimit ku nxënësi në mënyrë të rastësishme zgjedh njërën prej tyre. Komisioni i provimit duhet të përgatitë paraparakisht instrumentin e vlerësimit me procedurat/hapat/etapat e kryerjes së detyrave. Komisioni nuk duhet të ndërhyjë gjatë zhvillimit të provimit.

Udhëzime për realizimin e **Detyrës 1: “Punime druri me mjete të dorës dhe me makina”**
 Vlerësimi i një ose më shumë prej punimeve me mjete të mekanizuara të dorës, si sharra, zdrukthe, trapano, frezë dhe zumparuese, me makinat bazë të përpunimit të drurit si sharrë shirit, disk, plan, grosetë, punime me makinat e shpimit, frezimit dhe thithëzimit në bazë të procedurave përkatëse. Nxënësi duhet të testohet për një ose disa procese pune në mjete të mekanizuara apo makina si: (të masë dhe të shënojë elementet sipas skicës; të realizojë punimet e elementeve sipas modelit, për shembull në makinën frezë të realizojë bërjen e thithave për lidhje; të hapë kanalet sipas përmasave në skicë; etj.

Kjo detyrë do të realizohet në mjedisin e praktikës së përpunimit të drurit me poste pune. Nxënësve ju vihet në dispozicion skica të llojeve të punimeve, lëndë e parë, katalogë, manuale, udhëzues, materiale të shkruara, kompleti i veglave, pajisjeve dhe materialeve të

nevojshme për punime me mjete të mekanizuara të dorës me makinat bazë të përpunimit të drurit dhe me makina shpimi, frezimi, thithëzimi.

Nxënësi testohet për përzgjedhjen e materialeve dhe veglave të domosdoshme si dhe për një ose më shumë prej punimeve me mjete të mekanizuara të dorës, me makinat bazë të përpunimit të drurit dhe me makina shpimi, frezimi, thithëzimi. Komisioni vlerësues mbikëqyr nxënësin në proceset konkrete që ai kryen, si dhe zhvillon bashkëbisedim profesional. Nxënësi duhet të vlerësohet në mënyrë individuale dhe instrumenti i vlerësimit duhet të jetë lista e kontrollit, e cila hartohet nga komisioni vlerësues. Kjo listë kontrolli duhet të përmbajë të gjitha hapat dhe elementet e realizimit të kësaj detyre.

Udhëzime për realizimin e **Detyrës 2. “Punimi i dritares dhe derës prej druri”**

Vlerësimi i një ose më shumë prej proceseve të punës në përgatitjen e elementeve për dritare ose derë druri dhe për montim duke përdorur makina, në bazë të procedurave përkatëse. Nxënësi duhet të testohet për një proces pune, si: (matja dhe shënimi mbi materialin drunor sipas skicës; thithëzimi i elementeve; përgatitja e zemrës së derës ose dritares prej druri; shkurtimi i materialit drunor; drejttimi i materialit të shkurtuar në brinjë; etj.).

Kjo detyrë do të realizohet në mjedisin e praktikës së përpunimit të drurit me poste pune.

Nxënësve ju vihet në dispozicion skica e derës dhe e dritares prej druri, materiale të ndryshme drusorë për prodhimin e derës dhe dritares, materiale ndihmëse, instrumente prerës, instrumente shënues, matës dhe kontrollues, katalogë, manuale, udhëzues. Materiale të shkruara, kompleti i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për përgatitjen e elementeve për dritare ose derë druri.

Komisioni vlerësues mbikëqyr nxënësin në proceset konkrete që ai kryen, si dhe zhvillon bashkëbisedim profesional. Nxënësi duhet të vlerësohet në mënyrë individuale dhe instrumenti i vlerësimit duhet të jetë lista e kontrollit, e cila hartohet nga komisioni vlerësues. Kjo listë kontrolli duhet të përmbajë të gjitha hapat dhe elementet e realizimit të kësaj detyre.

Udhëzime për realizimin e **Detyrës 3, “Punime veshje me tapiceri të sipërfaqeve të ndryshme ”**

Vlerësimi i një ose më shumë prej proceseve të punës për veshjen me tapiceri të sipërfaqes,. Nxënësi duhet të testohet për një ose disa procese pune për tapicimin e sipërfaqeve: (si prerja e sfungjerit; preja e mbulesës; lyerja e sfungjerit me lëndë ngjitëse; vendosja e sfungjerit në sipërfaqen e caktuar; vendosja e mbulesës; mbërthimi i mbulesës; etj.).

Kjo detyrë do të realizohet në mjedisin e praktikës së përpunimit të drurit me poste pune.

Nxënësve ju vihet në dispozicion skica të sipërfaqeve që do të vishen me tapiceri, materiale të ndryshme drusore për veshje me tapiceri, materiale ndihmëse tapicerie për veshje të sipërfaqeve, katalogë, manuale, udhëzues, materiale të shkruara, kompleti i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për punime të veshjeve me tapiceri të sipërfaqeve të ndryshme.

Komisioni vlerësues mbikëqyr nxënësin në proceset konkrete që ai kryen, si dhe zhvillon bashkëbisedim profesional. Nxënësi duhet të vlerësohet në mënyrë individuale dhe instrumenti i vlerësimit duhet të jetë lista e kontrollit, e cila hartohet nga komisioni vlerësues. Kjo listë kontrolli duhet të përmbajë të gjitha hapat dhe elementet e realizimit të kësaj detyre.

Udhëzime për realizimin e **Detyrës 4, “Punime montimi të objekteve prej druri ”**

Vlerësimi i një ose më shumë prej proceseve të punës në montimin e elementeve sipas radhës, në bazë të procedurave përkatëse. Nxënësi duhet të testohet për një proces pune, në montimin e elementeve sipas radhës si: (të matë e shënojë mbi elementet e përgatitura sipas skicës; të bëjë shpime dhe të hapi fole me pajisjet e nevojshme për shpim; të përgatisë kunjat bashkues sipas përmasave në skicë; të veshë brinjët e pllakave të prera me teni, rimeso, plastikë, duroalumin apo dru masiv; të vendosë aksesorët metalikë dhe plastikë sipas modelit; të montojë paraprakisht objektin, pa lëndë ngjitëse, për kontroll; të eleminojë defektet në rast se do ketë; të ndërtojë skeletin e objektit; etj.).

Kjo detyrë do të realizohet në mjedisin e praktikës së përpunimit të drurit me poste pune.

Nxënësve ju vihet në dispozicion skica të objektit që do të montohet, detale dhe pllaka drusore të punuara në makina, për montimin e mobilieve me elementë të drejtë, me pllakë zdrukthi, fibër dhe materiale ndihmëse, instrumente prerëse, instrumente shënuese, matëse dhe kontrolluese, kompleti i veglave, pajisjeve dhe makinave, mjete ilustruese, materiale të shkruara, udhëzues, katalogë, kompleti i veshjeve të punës.

Komisioni vlerësues mbikëqyr nxënësin në proceset konkrete që ai kryen, si dhe zhvillon bashkëbisedim profesional. Nxënësi duhet të vlerësohet në mënyrë individuale dhe instrumenti i vlerësimit duhet të jetë lista e kontrollit, e cila hartohet nga komisioni vlerësues. Kjo listë kontrolli duhet të përmbajë të gjitha hapat dhe elementet e realizimit të kësaj detyre.

Udhëzime për realizimin e **Detyrës 5, “Patinimi, lustrimi, riparimi dhe restaurimi të mobilieve “**

Vlerësimi i një ose më shumë prej proceseve të punës në riparimin dhe restaurimin e mobilieve, në bazë të procedurave përkatëse” Nxënësi duhet të testohet për një nga proceset e punimeve për riparimin gjatë ndërtimit të mobilieve dhe tapicerisë si: (të pastrojë brinjët e veshura me defekt nga tenia, rimesua, plastika etj., , të veshi me kujdes brinjën e pastruar me rimeso, teni, plastikë, të zumparojë atë pjesë të sipërfaqes të patinuar me defekt; të pastrojë sipërfaqen e zumparuar, të kryejë ribojatisjen, në detalin apo pllakën duke mos ndryshuar ngjyrën; të riparojë defekte të ndryshme gjatë punimeve në tapiceri të skeleteve prej druri, metali apo plasike, si vendosje, gabim të sustave, sfungjerit, veshje damaske etj).

Për proceset e imitimit, patinimit dhe lustrimit me pllaka dhe detale prej druri (të përgatitë sipërfaqen e pllakës për imitim me materialin imitues; të kryejë procese të imitimit të drurit mbi pllakë sipas modelit me pajisje dore apo me makinat përkatëse; të përgatitë sipërfaqen e pllakës, detalit prej druri për patinimim; të përgatitë materialin patinues sipas recetës përkatëse; të kryejë procese të patinimit me dorë, pajisje dore apo me makina, të kryejë procese të tharjes së pastës patinuese në pajisje tharëse sipas rrëgjimit; të kontrollojë cilësinë e patinimit, të përgatitë lëndën për lysterje apo lustrim të drurit ,të lyejë apo lustroje me pajisje sprucimi, me makinë pllakat, detalet prej druri, të kryejë procesin e tharjes së bojës ose lëndës lustruese sipas rrëgjimit; të kontrollojë cilësinë e lustrimit sipas standardit; të kryejë pastrime dhe mirëmbajtje të pajisjeve dhe makinave.

Për proceset e punimeve për restaurimin e mobilieve të vjetra. si: (pastrimi i mobilieve së vjetër ; zberthimi në pjesët përbërse; eliminimi i elementeve të dëmtuara; dezinfektimi me antiseptikë; zëvendësimi i elementeve të dëmtuara; ngjitja e rimesos; zumparimi i elementeve; përgatitja e bojës për lysterje; lysterja me bojë etj.

Kjo detyrë do të realizohet në mjedisin e praktikës së përpunimit të drurit me poste pune.

Udhëzime për realizimin e Detyrës 6: **“Punime i mobilies së tapicuar me skelete të ndryshme”**

Vlerësimi i një ose më shumë prej proceseve të punës për veshjen me tapiceri të sipërfaqes, në bazë të procedurave përkatëse. Nxënësi duhet të testohet për një proces pune, në punimin e skeletit prej druri, fibre, kompensate (të matë dhe shënojë sipas skicës mbi material për punimin e skeletit të mobilies që do vishet me tapiceri; të sharrojë sipas shënimit mbi pllakën e fibrës ose kompensatës për kolltukun, divanin, karrigen e tapicuar, të shkurtojë materialin ,të drejtojë materialin sipas trashësisë të kërkuar; të punojë materialin në makinën zdruguese sipas trashësisë të kërkuar, të presë materialin sipas skicës me masa fikse detalet; të përgatisë shpinën mbështetësen, krahët, kllapat apo këmbët sipas skicë, të zumparojë këmbët, të lyejë këmbët me bojë ose llak, të montojë elementet për formimin e ndenjësës etj.). Procesi i punës veshja me tapiceri e skeletit (si prerja e sfungjerit; preja e mbulesës; lyerja e sfungjerit me lëndë ngjitëse; vendosja e sfungjerit në skeletin e mobilies në ndenjësë, në mbështetëse, në krah, të vendosi mbulesën me igelit, damaskë sipas kërkesës; të mbërthejë mbulesën me thumba, të montojë këmbët sipas skicës; të kontrollojë cilësinë etj.). Kjo detyrë do të realizohet në mjedisin e praktikës së përpunimit të drurit me poste pune.

Nxënësve ju vihet në dispozicion skica të sipërfaqeve që do të vishen me tapiceri, materiale të ndryshme drusore për veshje me tapiceri, materiale ndihmëse tapicerie për veshje të sipërfaqeve, katalogë, manuale, udhëzues, materiale të shkruara, kompleti i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për punime të veshjeve me tapiceri të sipërfaqeve të ndryshme. Komisioni vlerësues mbikëqyr nxënësin në proceset konkrete që ai kryen, si dhe zhvillon bashkëbisedim profesional. Nxënësi duhet të vlerësohet në mënyrë individuale dhe instrumenti i vlerësimit duhet të jetë lista e kontrollit, e cila hartohet nga komisioni vlerësues. Kjo listë kontrolli duhet të përmbajë të gjitha hapat dhe elementet e realizimit të kësaj detyre. Nxënësve ju vihet në dispozicion detale, pllaka prej druri që do riparohen, skelete të tapicuara, mobilie e vjetër, etj. kompleti i veglave, pajisjeve për riparim të defekteve dhe si dhe restaurimin e mobilieve të vjetra, materiale ndihmëse për riparim dhe restaurim, mjete ilustruese, materiale të shkruara, udhëzues, kompleti i veshjeve të punës.

Komisioni vlerësues mbikëqyr nxënësin në proceset konkrete që ai kryen, si dhe zhvillon bashkëbisedim profesional. Nxënësi duhet të vlerësohet në mënyrë individuale dhe instrumenti i vlerësimit duhet të jetë lista e kontrollit, e cila hartohet nga komisioni vlerësues. Kjo listë kontrolli duhet të përmbajë të gjitha hapat dhe elementet e realizimit të kësaj detyre.